

**INTERVISTË E ZNJ. ISABELLE FALQUE-PIERROTIN,
KREU I AUTORITETIT FRANCEZ TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE (CNIL)
PËR GAZETËN “THE NEW YORK TIMES”**

Znj. Isabelle Falque-Pierrotin shfaqet si një prej vëzhguesve më të rëndësishëm për mënyrën se si kompani si Facebook dhe Google përpunojnë miliarda të dhëna personale si: emra, data dhe kontakte, të cilat mblidhen në mënyrë të vazhdueshme për evropianët. Ajo është kreu i Autoritetit francez për mbrojtjen e privatësisë që prej vitit 2011 dhe këto dy vitet e fundit, drejton një grup zyrtarësh evropianë të mbrojtjes së të dhënave (Grupi i Punës i Nenit 29). Në këto poste, znj. Falque-Pierrotin i ka nxitur kompanitë që të ruajnë në mënyrë më të sigurt të dhënat personale të individëve.

Roli i saj do të ketë fokus edhe më të mprehtë javët e ardhshme. Znj. Falque-Pierrotin, e autorizuar nga gjykata më e lartë në Evropë, do të jetë në qendër të përpjekjeve për detyrën e mbikëqyrësit të mënyrës se si të dhënat personale transferohen jashtë Bashkimit Evropian, një aspekt qendror i shumë bizneseve të Amerikës dhe Evropës. Ky rol do të përforcohet edhe më tej nëse, siç pritet nga të gjithë, negociatorët evropianë dhe amerikanë nuk arrijnë një marrëveshje të re për transferimin e të dhënave deri në datën 1 shkurt.

[*Zyrtarët evropianë dhe ata amerikanë arritën në 2 shkurt 2016 të bien dakord për hartimin e një marrëveshje të re për këtë qëllim, që do të quhet “Privacy Shield – Mbyroja e Privatësisë”. \(në fund të shkrimit një përmbledhje e deklaratës për shtyp për arritjen e marrëveshjes në parim BE-SHBA për “Privacy Shield – Mbyroja e Privatësisë”\)](#)

Ja se si Evropa po shkon pas Google, Amazon dhe gjigandëve të tjerë të teknologjisë së SHBA

Kompanitë më të mëdha amerikane të teknologjisë përballen me mbikëqyrjen intensive nga regullatorët evropianë, me një presion që mundësisht mund të ulë fitimet e tyre në rajon dhe të ndikojë në mënyrën se si ata operojnë nëpër botë.

Një gjë është e qartë thekson ajo, praktikrat e kompanive të teknologjisë dhe bizneseve të tjera amerikane, në veçanti, janë të drejtpërdrejta në pikëpamjet e saj. “Kompanitë amerikane nuk kanë një të drejtë të menjëhershme për të mbledhur të dhëna për qytetarët tanë”, tha kohët e fundit në një intervistë 56-vjeçarja Falque-Pierrotin. “Nëse ata janë në territorin tonë, atëherë duhet të jetojnë me pasojat.”



Çështja e mbikëqyrjes më të madhe u la në duart e rregullatorëve evropianë të të dhënave personale në tetor 2015, kur Gjykata Evropiane e Drejtësisë anuloi një pakt 15-vjeçar, i njohur ndryshe si “Safe Harbour – Porti i Sigurt”, i cili u kishte lejuar kompanive të ndryshme të shkëmbenin informacion midis Shteteve të Bashkuara dhe Evropës. Gjyqtarët vendosën se të dhënat e qytetarëve evropianëve nuk kishin mbrojtje të mjaftueshme kur transferoheshin drejt Shteteve të Bashkuara.


Menjëherë pas kësaj, rregullatorët kombëtarë që drejtohen nga znj. Falque-Pierrotin (Grupi i Punës të Nenit 29) kërkuan që Komisioni Evropian dhe Departamenti i Tregtisë të arrinin një marrëveshje të re në datën 1 shkurt 2016. Që prej tetorit, negociatorët kanë zhvilluar bisedime të përditshme, duke përfshirë ato në Bruksel dhe Davos të Zvicrës, së fundmi. Akoma ka mosmarrëveshje për mënyrën se si agjencitë inteligjente amerikane monitorojnë profilet digjitale të evropianëve, sipas disa zyrtarëve, të cilët kanë komentuar në kushte anonimati.

Nga dështimi për të gjetur një kompromis, drejtuesit e kompanive dhe zyrtarët paralajmërojnë se mund të ndërpritet fluksi i miliarda dollarëve të tregtisë midis dy ekonomive më të mëdha në botë. Pothuajse të gjithë kompanitë e mëdha ndërkombëtare, duke përfshirë prodhuesit si General Electric dhe prodhuesit e medikamenteve si Pfizer, në mënyrë të vazhdueshme shpërndajnë të dhëna të klientëve nëpër rajone të ndryshme të botës.

Megjithatë, ndikimi më i madh do të jetë ai i gjigandëve të teknologjisë së Shteteve të Bashkuara, si [Facebook](#) dhe [Google](#), të cilët i grumbullojnë të dhënat personale nga publikimet në mediat sociale, pyetjet e kërkimit dhe blerjet *online*, për të nxitur bizneset e reklamave digjitale. Këto përpjekje shpesh të çojnë drejt tensionit në Evropë, ku privatësia konsiderohet si e shenjtë, ashtu si edhe liria e fjalës.

Me apo pa marrëveshje, znj. Falque-Pierrotin është në një pozicion për të luajtur një rol të madh. Nëse negociatorët bien dakord për një pakt të ri, ajo dhe mbikëqyrësit e tjerë evropianë të privatësisë do të shqyrtojnë përmbajtjen e marrëveshjes së re nëse ajo përmbush standardet strikte të Unionit. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, ajo mund të vendosë kufizime shtesë për mënyrë se si të dhënat personale transferohen përtej Atlantikut, kur rregullatorët evropianë të mblidhen në datën 2 shkurt në Bruksel.

“Francezët nuk kanë frikë që t’i hedhin në gjyq këto kompani”, tha Max Schrems, një student austriak në degën e juridikut, që paraqiti në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë rastin mbi të cilin u bazua edhe vendimi i saj për ta konsideruar të pavlefshme marrëveshjen “Safe Harbour – Porti i Sigurt”.



Znj. Falque-Pierrotin ndjek një traditë të gjatë të zyrtarëve francezë, duke promovuar të drejta strikte të privatësisë. Në vitin 2014, kolegët e saj e zgjodhën atë për të drejtuar një grup gjithnjë e më të fuqishëm të rregullatorëve evropianë të privatësisë (Grupi i Punës të Nenit 29) – pozicion të cilin me shumë gjasë ajo do ta mbajë edhe për një mandat tjetër, kur të zhvillohen zgjedhjet muajin e ardhshëm.

Pas përfundimit të edukimit akademik në disa prej institucioneve më të mira publike dhe private, znj. Falque-Pierrotin për më shumë se tri punoi në disa agjenci shtetërore dhe organizma jofitimprurëse. Në fund të viteve 90-të, ajo u fokusua më shumë në fushën e privatësisë dhe tek ekonomia digjitale. Znj. Falque-Pierrotin iu bashkua autoritetit francez të mbrojtjes së të dhënave personale (CNIL) në vitin 2004 dhe me shpejtësi i ngjiti shkallët e hierarkisë në këtë institucion. Znj. Falque-Pierrotin shfaqet si një individ i qetë dhe formal. Por mbështetësit dhe kundërshtarët e saj thonë se ajo mund të jetë edhe kokëfortë, por gjithnjë e paanshme. Vitet e fundit ka fituar reputacion për iniciativën e të trajtuarit të çështjes së privatësisë kundër kompanive të mëdha të teknologjisë në botë, përfshirë këtu edhe ndaj Google.

Gjigandi i kërkimit do të jetë sërish në qendër të vëmendjes në javët e ardhshme, kur mbikëqyrësi francez i mbrojtjes së të dhënave pritet që të gjobisë kompaninë për moszbatimin e vendimit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, i njohur si “E drejta për tu harruar”, sipas dy personave me njohuri të drejtpërdrejtë për këtë çështje në fjalë, të cilët kanë folur në kushtet e anonimatit. Një gjobë e tillë përbën në fakt shqetësim për reputacionin e kompanive si Google, sepse ndëshkimi maksimal i Agjencisë (CNIL) me gjobë do të jetë 150.000 euro, (rreth 160.000 dollarë amerikanë).

Në një intervistë të kohëve të fundit, znj. Falque-Pierrotin tha se çdo qytetar evropian ka të drejtë t’i kërkojnë Google të fshijnë çdo informacion për ta, në këtë motor kërkimi botëror. Megjithatë, ajo nuk pranoi të komentojë në lidhje me gjobitjen e mundshme të kompanisë. Gjithashtu, një zëdhënës i Google refuzoi të komentonte për çështjen e gjobës. Kompania

Google ka deklaruar se vendimi në fjalë i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë duhet të zbatohet vetëm për domainet evropiane si p.sh. Google.fr dhe jo në domenin global Google.com.

Edhe në ballafaqimin me Google, ekspertët francezë të privatësisë thonë se znj. Falque-Pierrotin ka kontaktuar rregullisht kompanitë ndërkombëtare dhe vendore. Ajo ka ndërmarrë një qasje më pak kundërshtuese se në vende të tjera, si p.sh. në Gjermani, ku zyrtarët shpesh janë treguar të ethshëm për t'ia hedhur fajin kompanive amerikane për shkeljen e rregullave vendore.

Ahmed Baladi, një avokat i zyrës Allen & Overy, i cili përfaqësoi Google në një çështje të mëparshme të mbrojtjes së të dhënave personale në Francë, tha se znj. Falque-Pierrotin e drejton institucionin që përfaqëson në mënyrë agresive. “Por strategjia e saj fokusohet, gjithashtu, në komunikim, jo vetëm në zbatim strikt të ligjit për mbrojtjen e të dhënave”, shtoi ai.

Kjo qasje plot nuanca mund të jetë e dobishme edhe në diskutimet e minutës së fundit për arritjen e marrëveshjes së re të transferimit të të dhënave personale përtej Atlantikut.

Autoritetet kombëtare mund të nisin procedime ligjore – deri në vendosjen e gjobave – kundër kompanive që veprojnë në kundërshtim me rregullat e forta evropiane të mbrojtjes së të dhënave personale, nëse nuk arrihet një marrëveshje e re.

Znj. Falque-Pierrotin, ka marrë ankesa kundër disa kompanive të panjohura, por po pret deri në muajin shkurt për të vendosur nëse do të fillojë hetimet për disa kompani të cilat transferojnë të dhëna nga Franca në Shtetet e Bashkuara.

Znj. Vera Jourova, Komisioner i Bashkimit Evropian për Drejtësinë, Konsumatorët dhe Barazinë Gjinore, në krye të ekipit negociator të Unionit, akoma mendon se mund të arrihet një marrëveshje e re për transferimin e të dhënave personale, por paralajmëron se “një marrëveshje do të bëhet vetëm nëse do të ketë një qasje të drejtë në Shtetet e Bashkuara” për të ruajtjen e drejtë të privatësisë për qytetarët evropianë.

Bruce Andrews, Zv/sekretar i Departamentit amerikan të Tregtisë, hodhi poshtë shqetësimet e Evropës, duke thënë se Shtetet e Bashkuara i kanë ofruar tashmë Komisionit Evropian një numër garancish mbi mënyrën e trajtimit të të dhënave të qytetarëve. “Kemi rënë dakord të bëjmë ndryshime të mëdha”, theksoi ai. “SHBA e trajton me shumë seriozitet privatësinë e individëve”.

Në muajin dhjetor, znj. Falque-Pierrotin u dërgoi letra disa agjencive amerikane, përfshi Departamentin e Tregtisë dhe Komisionin Federal të Tregtisë, duke u kërkuar takime për të diskutuar mbi këtë çështje. Ajo mori vetëm një përgjigje të shkurtër.

Duke mos iu përgjigjur në mënyrë të plotë znj. Falque-Pierrotin, mund të rezultojë e kushtueshme. Tashmë, rregullatori francez dhe agjenci të tjera homologe evropiane, u kanë dërguar letra kompanive ndërkombëtare duke u kujtuar se mekanizmi aktual për transferimin e të dhënave personale është në kundërshtim me bazën ligjore.

Një numër i madh avokatësh për mbrojtjen e të dhënave personale në rrjetet digjitale, përfshirë z. Schrems, po përgatisin padi të tjera për mbrojtjen e privatësisë, nëse nuk arrihet një marrëveshje brenda datës 1 shkurt 2016.

Me shumë gjasa kjo mund të shkaktojë më shumë probleme për gjigandët e teknologjisë amerikane, duke shtyrë znj. Falque-Pierrotin dhe homologët e saj evropianë që të marrin parasysh hetime të reja dhe eventualisht gjoba. Por pozicioni i saj mbi mbrojtjen e të dhënave personale vazhdon të jetë i palëkundur.

“A ofron SHBA garanci të mjaftueshme për privatësinë?”, theksoi ajo. “Deri tani, përgjigja është jo.”

Njoftim për shtyp
Komisioni Evropian dhe Shtetet e Bashkuara bien dakord për një marrëveshje të re për transferimin e të dhënave përtej atlantikut: “Privacy Shield – Mbuuroja e Privatësisë”

2 shkurt 2016, Strasburg

Komisioni Evropian dhe Shtetet e Bashkuara kanë rënë dakord për një marrëveshje të re për transferimin e të dhënave përtej atlantikut: “Privacy Shield – Mbuuroja e Privatësisë”. Kolegji i Komisionerëve miratoi marrëveshjen politike dhe ka mandatuar Zv/presidentin Ansip dhe komisionerin **Jourová** për të ndërmarrë hapat e nevojshme në përgatitjen e kësaj marrëveshjeje. Kjo marrëveshje e re do të mbrojë të drejtat themelore të evropianëve kur të dhënat e tyre transferohen drejt Shteteve të Bashkuara dhe të sigurojë garanci ligjore për bizneset.

“Mbuuroja e Privatësisë” mes BE dhe SHBA reflekton kërkesat e përcaktuara nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë në vendimin e saj në 6 tetor 2015, e cila shpalli si të pavlefshëm paktin e vjetër “Safe Harbour – Porti i Sigurt”. Marrëveshja e re do të parashikojë detyrime më të forta për kompanitë në SHBA për të mbrojtur të dhënat personale të evropianëve dhe të përforcojë monitorimin dhe zbatimin e ligjit nga Departamenti i Tregtisë dhe Komisioni Federal i Tregtisë së SHBA, duke përfshirë rritjen e bashkëpunimit me Autoritetet evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Përgatiti Segi Berberi